



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Nr. 848 Prot,

Vlorë, më 03.04.2024

VENDIM

Nr. 6 Datë 26.03.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 20, DATË 28.12.2022 TË KËSHILLIT
TË QARKUT VLORE 'PËR STRUKTURËN ORGANIKE TË ADMINISTRATËS SË
KËSHILLIT TË QARKUT VLORE, PËR VITIN 2023'**

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur në datën e sipërpërmendur, në zbatim të Ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 77; Ligjit nr. 115, datë 25.11.2021, "Për buxhetin e vitit 2022, neni 15; VKM nr.474 dt.16/06/2011 "Për përcaktimin e standarteve dhe te procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike"; VKM nr.586 dt. 17.07.2013 "Për disa ndryshime në VKM nr. 1619, datë 02.06.2008 "Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore", VKM nr.142 datë 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucioneve të pavarura; VKM nr.621, dt. 28.9.2022 Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 625, datë 28.09.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 165, datë 02.03.2016"

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet në strukturën e Këshillit të Qarkut Vlorë sipas LIDHJES Nr.1.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Vlorë, Sekretari i Përgjithshëm, Sektori i Financës dhe Shërbimeve dhe Sektori i Urbanistikës, Zhvillimit të Territorit, Burimeve Njerezore, Arsimit, Kulturës, Turizmit dhe Çështjeve Sociale
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit 139/2015, date 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore".

KRYETAR

Ervis Moçka



Shpalluar nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkrësë Nr. _____ Prot, datë _____.2024

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës "Labëria" Vlorë
Vlorë (AL), 9401

Website: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +355 33 421 600



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Lidhja 1 - Ishte

STRUKTURA

I	KRYETARI, ZV.KRYETARI, SEKRETARI DHE KABINETI I KËSHILLIT TË QARKUT					
1	Kryetar i Këshillit të Qarkut	1	një		I mandatar	170.000
2	Zv. Kryetar i Këshillit të Qarkut	1	një		I mandatar	125.000
3	Sekretar i Këshillit të Qarkut	1	një	IB	I emëruar	90.000
4	Zdh. Kryetarit dhe këshilltare për projektet e BE-së	1	një	IIB	Mbështetës	70.000
5	Sekretar i Përgjithshëm	1	një	IB	Nëpunës Civil	100.000
I SEKTORI I FINANCES DHE SHERBIMEVE						
6	Përgjegjës Sektori Finance -Buxhet	1	një	III-al	Nëpunës Civil	80.300
7	Specialist për zbatimin e buxhetit dhe projekteve	1	një	IIIB	Nëpunës Civil	70.000
8	Specialist për Asistence juridike në implementimin e projekteve dhe prokurimeve	1	një	IIIB	Nëpunës Civil	70.000
9	Specialist për shërbimet, fatkeqesitë natyrore, mjedisin, ushqimin dhe shëndetësinë	1	një	IIIB	Nëpunës Civil	70.000
II SEKTORI I URBANISTIKËS, ZHVILLIMIT TË TERRITORIT, BURIMEVE NJEREZORE, ARSIMIT, KULTURËS, TURIZMIT DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE						
10	Përgjegjës Sektori (Personeli, Sekretari Arkivës)	1	një	III-al	Nëpunës Civil	80.300
11	Specialist Jurist	1	një	IIIB	Nëpunës Civil	70.000
12	Specialist për Urbanistikën dhe zhvillimin e territorit	1	një	IIIB	Nëpunës Civil	70.000
13	Specialist për Arsimin, Kulturën, Turizmin, Çështjet Sociale dhe zhvillimin e Projekteve	1	një	IIIB	Nëpunës Civil	70.000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

III	FUNKSIONE TË DELEGUARA - DREJTORIA E ADMINISTRIMIT DHE MBROJTJES SË TOKËS					
14	Drejtor i DAMT	1	një	IIIB	Nëpunës Civil	80.000
	Sektori i Administrimit dhe Mbrotjes së Tokës					
15	Specialist Vlorë	1	një	IV-3	Nëpunës Civil	60.000
16	Specialist Vlorë	1	një	IV-3	Nëpunës Civil	60.000
17	Specialist Vlorë	1	një	IV-3	Nëpunës Civil	60.000
18	Specialist Sarandë	1	një	IV-3	Nëpunës Civil	60.000
19	Specialist Sarandë	1	një	IV-3	Nëpunës Civil	60.000
20	Specialist Delvinë	1	një	IV-3	Nëpunës Civil	60.000

Lidhja 1 - Bëhet

STRUKTURA

I	KRYETARI, ZV.KRYETARI, SEKRETARI DHE KABINETI I KËSHILLIT TË QARKUT					
1	Kryetar i Këshillit të Qarkut	1	një		I mandatuar	170.000
2	Zv. Kryetar i Këshillit të Qarkut	1	një		I mandatuar	125.000
3	Sekretar i Këshillit të Qarkut	1	një	IB	I emëruar	90.000
4	Zdh. Kryetarit dhe këshilltare për projektet e BE-së	1	një	IIB	Mbështetës	70.000
5	Këshilltar për pushtetin vendor, komunikimin dhe zhvillimin teknologjik	1	një	IIB	Mbështetës	70.000
6	Sekretar i Përgjithshëm	1	një	IB	Nëpunës Civil	100.000
I	SEKTORI I FINANCES DHE SHERBIMEVE					
7	Përgjegjës Sektori Finance -Buxhet	1	një	III-a1	Nëpunës Civil	80.300



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

8	Specialist për zbatimin e buxhetit dhe projekteve	1	një	IIIB	Nënpunës Civil	70.000
9	Specialist për shërbimet dhe fatkeqesitë natyrore	1	një	IIIB	Nënpunës Civil	70.000
II SEKTORI I URBANISTIKËS, ZHVILLIMIT TË TERRITORIT, BURIMEVE NJEREZORE, ARSIMIT, KULTURËS, TURIZMIT DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE						
10	Përgjegjës Sektori (Personeli, Sekretari Arkivës)	1	një	III-a1	Nënpunës Civil	80.300
11	Specialist Jurist	1	një	IIIB	Nënpunës Civil	70.000
12	Specialist për Urbanistikën dhe zhvillimin e territorit	1	një	IIIB	Nënpunës Civil	70.000
13	Specialist për Arsimin, Kulturën, Turizmin, Çështjet Sociale dhe zhvillimin e Projekteve	1	një	IIIB	Nënpunës Civil	70.000
III FUNKSIONE TË DELEGUARA - DREJTORIA E ADMINISTRIMIT DHE MBROJTJES SË TOKËS						
14	Drejtor i DAMT	1	një	IIIB	Nëpunës Civil	80.000
Sektori i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës						
15	Specialist Vlorë	1	një	IV-3	Nëpunës Civil	60.000
16	Specialist Vlorë	1	një	IV-3	Nëpunës Civil	60.000
17	Specialist Vlorë	1	një	IV-3	Nëpunës Civil	60.000
18	Specialist Sarandë	1	një	IV-3	Nëpunës Civil	60.000
19	Specialist Sarandë	1	një	IV-3	Nëpunës Civil	60.000
20	Specialist Delvinë	1	një	IV-3	Nëpunës Civil	60.000



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 21, DATË 28.12.2022 TË KËSHILLIT
TË QARKUT VLORË 'PËR STRUKTURËN ORGANIKE TË ADMINISTRATËS SË
KËSHILLIT TË QARKUT VLORË, PËR VITIN 2023"
VLORË**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në kushtet e ndryshimeve të kuadrit ligjor në fuqi i cili përcakton nivelin dhe kufijtë minimal dhe maksimal të pagave përkatësisht Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 165, datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 625, datë 28.09.2022 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 165, datë 02.03.2016.." si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 187, datë 8.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve," i ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 28.09.2022 "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 187, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendës ministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike", në muajin Shtator 2023 u miratuan disa ndryshime në nivelin e pagave në kufijtë maksimal të përcaktuar në kuadrin ligjor në fuqi të sipërcituar për pozicionet e punës në strukturën e Këshillit të Qarkut Vlorë, në strukturën e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Këshillin e Qarkut Vlorë si dhe në strukturën të Qendrës Psiko - Sociale "Vatra" në Këshillin e Qarkut. Por nuk pati ndryshime në emërtim dhe funksione.

Nga relacionet vjetore të sektorëve rezultoj se disa emërtime të funksioneve të specialistëve nuk përputhen më me funksionet, pasi shumë funksione prej kohësh u janë transferuar Bashkive. Për këtë arsye propozojmë ndryshimet në emërtim si më poshtë:

1. Nga Specialist për shërbimet, fatkeqesitë natyrore, mjedisin, ushqimin dhe shëndetësinë, bëhet Specialist për shërbimet dhe fatkeqesitë natyrore.
2. Ndërkohë që pozicioni i Specialistit për Asistencë juridike në implementimin e projekteve, me përfundimin e projekteve ndërkufitare dhe me ngritjen në detyrë të specialistit përkatës në Përgjegjës në Sektorin e urbanistikës, zhvillimit të territorit dhe burimeve njerëzore, shihet e arsyeshme mos të shpallet si vënd vakant por për më shumë fleksibilitet dhe për një koordinim më të mirë me bashkitë e qarkut, të kalojë si Këshilltar për pushtetin vendor,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

komunikim dhe zhvillimin teknologjik, duke marrë parasysh dhe zhvillimin e madh të sistemeve online, teknologjisë së informacionet dhe rolit të madh që ka kjo teknologji në zhvillimin ekonomik ashtu si dhe duke konsideruar se shumë nga shërbimet sot ofrohen online.

Sekretari i Përgjithshëm

Klaud Gjipali

Për Sektorin e Burimeve Njerëzore

Përgjegjës: Margarita Binaj

Për Sektorin e Financës

Përgjegjës: Anisa Hyseni